



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 260/2024

Datë: 19 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.25 dhe nenit 16 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 28 paragrafi 1 të Rregullores Nr.02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Prokurorial të Kosovës si dhe nenit 6 të Rregullores Nr.01/2023 për Komisionin Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve, në takimin e mbajtur më datë 19 mars 2024, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Komisioni Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve, në këtë përbërje:
 1. Lulzim Sylejmani, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit- Kryetar;
 2. Agron Qalaj, Prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit- Anëtar dhe
 3. Shehribane Selimi Muçaj, Prokurore në Prokurorinë e Apelit- Anëtare.
- II. Anëtarë rezervë të Komisionit Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve janë:
 1. Laura Pula, Prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit- Anëtare;
 2. Shkelzen Ibrahim, Prokuror në Prokurorinë e Apelit- Anëtar.
- III. Mandati i anëtarëve të këtij Komisioni është tre (3) vjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër.
- IV. Obligohen anëtarët e Komisionit Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve të përcaktuar në pikën I dhe II të këtij vendimi, që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t' i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- V. Anëtarët nga pika I dhe II largohen nga lista e paneleve hetimore.
- VI. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

VII. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Sekretariatit dhe Dosjes së Prokurorëve;
- Njësia për Panele Hetimore;
- Arkivit të KPK-së.